



Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Parimet e vendosjes së ngarkesave për gjeneratorët e rregulluar;
- Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar;
- Aplikacionin e KEK-Gjenerimit të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE7) me dokumentacionin relevant sqarues;
- Vendim nr. V_631_2014 për të Hyrat Maksimale të Lejuara për operatorët e licencuar Termocentrali Kosova A dhe Termocentrali Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar);dhe
- Kërkesën e datës 03 shkurt 2014 për çmime të rregulluara të gjenerimit.
- Azhurnimi i aplikacionit për ngarkesa të gjenerimit më datë 12 maj 2014.

Në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2014 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** çmimet e rregulluara që do të zbatohen nga operatori i licencuar i Termocentralit Kosova A dhe operatorit i licencuar Termocentrali Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar) për vitin relevant tarifor apo SHTE8, i cili fillon nga 1 prilli 2014.

ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjisë Elektrike e Kosovës SH.A. (KEK) kërkesën për shqyrtim të çmimeve të rregulluara të KEK-Gjenerimit;
- ✚ Në marrjen e vendimit të tij për MAR që do të mbulohet nga Gjeneratorët e Rregulluar përmes çmimeve të rregulluara, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:



- Vlerësimi i përfundimtar – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Raport Vlerësimin-Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar më datën 16 maj 2014;
- I. Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e ngarkesave për kapacitet dhe energji për KEK- Gjenerimin, që do të zbatohet në vitin relevant tarifor SHTE8 është si në tabelën mëposhtme.

Struktura e ngarkesave	Njësia	Ngarkesa
Ngarkesat për kapacitet	€/MW/h	18.63
Ngarkesa për energji	€/MWh	7.99

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, Kryesues

Merita Kostari, Anëtar

Krenar Bujupi, Anëtar